



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.05.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen i projektit kushtetues, parimet themelore nga neni 1 deri te neni 13 dhe neni 56.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Eduard Halimi, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Petrit Vasili.

Mungon:

Spartak Braho

Të ftuar:

Rainer Deville – shef i misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

Jon Smibert – përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

Agnes Benhard - zv/shefe e misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për reformën në drejtësi, shqyrtimin nën për nën të projektit kushtetues.

Sot kemi të programuar në rendin e ditës pjesën e parë, parimet themelore nga neni 1 deri te neni 13 dhe nenin 56.

Atëherë, fillojmë me nenin 1.

Po, zoti Halimi!

Eduard Halimi – Nga neni 1 deri te neni 13, siç e kemi thënë edhe më parë, janë nene *non sens*.

E para, këto nene nuk kanë të bëjnë me reformën në drejtësi, përveç nenit 10, në të cilin thuhet se ndryshohet Prokurori i Përgjithshëm me Prokurorin e Posaçëm. Pra, përveç këtij neni të gjitha nenet e tjera nuk kanë lidhje me reformën në drejtësi. Kur e lexon duket sikur ne jemi bërë anëtarë të Bashkimit Europian dhe na ngelet që të bëjmë disa detyra, pasi jemi bërë anëtarë.

Unë shpresoj dhe uroj që të bëhemi sa më shpejt, por koha nuk llogaritet me muaj, por me vite, të hapen negociatat dhe më pas të bëhemi anëtarë kur të plotësohen të gjitha kushtet dhe kriteret. Të shkruajmë tani që jemi bërë anëtarë dhe më pas të përcaktojmë detyrimet, mua më duket tërësisht e pakuptimtë. Nuk kam gjë kundër këtij, por e them se ata që do ta lexojnë pas 10 vjetësh apo më vonë, do të thonë: “Po mirë, këta nuk e dinin, nuk e kuptonin, kaq pa mend në kokë ishin që duhet t’i shkruanin që në vitin 2016 se çfarë do të bënin në vitin 2020, kaq vizionarë ishin?” Ndaj, argumenti i dhënë edhe gjatë muajve të mëparshëm kur e kemi diskutuar që ta ndryshojmë Kushtetutën tani, sepse kur të bëhemi anëtarë do të jemi aq të gëzuar sa nuk do të kemi kohë ta ndryshojmë Kushtetutën ose të mos e ndryshojmë dy herë, përsëri edhe kjo nuk qëndron. Të vijë një herë ajo ngjarje madhore për shqiptarët, jo që do të ndryshohet Kushtetuta, por ndoshta duhen bërë edhe ligje të tjera e me radhë.

Ky ishte një diskutim për nenet, megjithatë po ua lë fjalën kolegëve, pasi mund të kenë argumente më bindëse sesa kjo.

Fatmir Mediu – Pa dyshim, duke u pajtuar me shqetësimin që ngriti zoti Halimi, duke mos qenë kundër përmbajtjes dhe mënyrës se si janë shkruar nenet, fakti është se këto nene nuk kanë të bëjnë në thelb me reformën në drejtësi. Unë kam bindjen se ka ardhur koha

që ne duhet të mendojmë si trupë parlamentare që ka nevojë për një reformë kushtetuese të plotë dhe ky mund të jetë një hap tjetër i rëndësishëm që duhet do ta gjykojë Kuvendi i Shqipërisë. Në këtë kuadër të reformës së plotë kushtetuese, duhet parë qasja me këtë perspektivë europiane që kemi ne, si dhe rregullimet e nevojshme për të pasur një funksionim të drejtë të parimeve *check and balance*. Unë nuk mendoj se problemet kushtetuese kanë të bëjnë vetëm me gjyqësorin, ato kanë të bëjnë edhe me pushtetet e tjera dhe pa dyshim edhe me koherencën që duhet të kemi ne në raport me një mundësi, shpresoj sa më të afërt të Shqipërisë për t'u bërë vend anëtar i Bashkimit Europian. Pra, shqetësimi ynë nuk ka të bëjë me mënyrën sesi është shkruar, por ka të bëjë me faktin se a është i nevojshëm tani dhe a përfshihet tek ai fokus i punës të këtij komisionit të posaçëm?

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Unë ndaj të njëjtat këndvështrime me kolegët, pa diskutim. Do të isha edhe më entuziast që të njëjtat dispozita, madje edhe më të mira, sepse unë besoj se para të anëtarësohemi duhet të kalojnë edhe disa vjet, kështu që mund të kemi edhe këndvështrime shtesë, pra, do të isha entuziast t'i votoja këto dispozita në momentin kur jemi duke e kaluar dritën jeshile të semaforit. Siç jua thashë, ndoshta deri në atë moment, po t'i rilexojmë, do të themi që kemi lënë gjëra mangët, se do të kalojë kohë. Ndërkohë vizioni, sikundër e tha edhe kolegu parafolës, është absolutisht ai që duhet të kemi të gjithë ne. Unë nuk e besoj se këto dispozita na bëjnë anëtarë, ose mospasja e tyre sot në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë do të na pengojë ne për të qenë anëtarë.

Për shembull, ndryshimi që propozojmë në nenin 4 nuk na ka penguar që të bëhemi anëtarë të NATO-s dhe t'i përgjigjemi kësaj të fundit me të gjitha kapacitetet, nevojat edhe të karakterit kushtetues për të qenë anëtarë dhe për të operuar si të tillë. Ndërkohë, qoftë elementet që kanë të bëjnë me mënyrën si operon shteti në raport me Bashkimin Europian apo të drejtat që u lindin individëve, janë absolutisht për t'u miratuar përpara se Shqipëria të hyjë në Bashkimin Europian. Po ta bëjmë këtë sot duket diçka e tepërt, pra askush nuk mund të jetë kundër kësaj, por ndoshta do ta bëjmë më mirë kur të vijë koha. Pra, nuk po ndalim te neni 3 se ai nen ka probleme më vete dhe nuk është pjesë e Bashkimit Europian.

Gjykoj se është e papërshtatshme dhe ndoshta po nxitojmë, ndoshta do të lëmë gjëra mangët nga ato që do të na duhen vërtetë në momentin kur jemi duke u bërë anëtarë të Bashkimit Europian. Siç e tha edhe ambasadorja Vlahutin, e gjithë ajo që ne mund të presim në momentin e hapjes së negociatave, është hapja e negociatave për dy kapituj shumë të rëndësishëm: luftën kundër krimit dhe luftën kundër korrupsionit. Rruga që do të na duhet për

t'i bërë të gjithë këta kapituj ka për të qenë e gjatë dhe deri atëherë do të dalin çështje të tjera, besoj se ndajmë të njëjtin mendim: ta lëmë entuziazmin e tepërt, të jemi racional për diçka që e kemi sot si detyrë, reformën në drejtësi dhe jam dakord me atë që thotë zoti Mediu. Ne jemi duke bërë një reformë të rëndësishme dhe ndoshta kjo reformë në sistemin e drejtësisë po çon nevojën për të balancuar të tërë strukturën e Kushtetutës dhe ndoshta jemi përpara nevojës për një reformë më të thellë kushtetuese. Atëherë mund të gjykojmë me mendje të ftohtë nëse janë këto nene apo edhe të tjera që duhet të shtojmë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, 13 nenet që ne po i diskutojmë sot plus nenin 56, unë do t'i ndaja në dy kategori:

Janë 5 nene, të cilat lidhen me integrimin European, pra me anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin European, ndërsa 9 nenet e tjera janë të lidhura drejtpërdrejtë me reformën në drejtësi. Lidhur me 4 nenet ose dispozitat që lidhen me detyrimet që ka Republika e Shqipërisë pas anëtarësimit, kjo është një çështje për të cilën mund të pyesim ekspertët, por mendoj absolutisht se nuk ka asnjë gjë të keqe në qoftë se ne kemi ndërhyrë apo ndërhyrjet në Kushtetutë të jenë.

Lidhur me 9 nenet e tjera ato janë të lidhura drejtpërdrejtë me reformën në drejtësi. Më lejoni të argumentoj lidhjet te neni 1, ku u referohemi vlerave europiane për të vazhduar deri te neni 11.

Siç e dimë, Kushtetuta është miratuar në vitin 1998 dhe deri në atë kohë ne nuk i kemi botuar dhe nuk kemi pasur shumë marrëveshje ndërkombëtare. Pas vitit 1998, me miratimin e Kushtetutës, Shqipëria ka pasur detyrimin që jo vetëm marrëveshjet e ratifikuara të botohen në Fletoren Zyrtare dhe të fillojnë të zbatohen, sepse kanë përparësi, por ne kemi qenë shumë aktiv si shtet shqiptar, sidomos nga viti 2000 deri në vitin 2005, por edhe më pas në vitet e fundit, duke ratifikuar një sërë konventash.

Ne kemi nënshkruar MSA-në dhe nënshkrimi i saj është bërë pas miratimit të Kushtetutës. Ne jemi pjesë e NATO-s dhe qenia anëtar i NATO-s është bërë pasi kemi miratuar Kushtetutën. Nëse do të më lejoni, për të thënë se këto nene janë të nevojshme dhe lidhen drejtpërdrejt me reformën në drejtësi, po e nis që me nenin 3 për të cilin ju keni një qëndrim ndryshe, por kur të vijmë në diskutimin nen për nen mund ta diskutojmë.

Neni 4 ka lidhje, sepse Shqipëria është pjesë e NATO-s dhe si e tillë merr pjesë në shumë operacione dhe është e nevojshme që në Kushtetutë të qartësohet ose të saktësohet sesi angazhohen forcat ushtarake shqiptare jashtë vendit, dhe sesi forcat e huaja ushtarake mund të kalojnë ose të vendosen në territorin e Shqipërisë.

Gjithashtu, neni 5 është i detyrueshëm, është rekomandim, sepse neni 18 aktual i Kushtetutës bie ndesh me një sërë konventash e protokolleve shtesë që Shqipëria ka ratifikuar. Ndërkohë, në legjislacionin shqiptar ne kemi referuar një sërë bazash mbi të cilat ndalohet diskriminimi, njëkohësisht kemi nënshkruar protokollin 12 që ndalon çdo lloj diskriminimi, ndërsa në Kushtetutë bazat mbi të cilën mund të diskriminohet një person e kishim shumë më të limituar. Nga ana tjetër, kolegë të nderuar, doja të sillja në vëmendjen tuaj ndryshimet që kemi bërë në vitin 2012 në Kodin Penal, ndryshimet që bëmë në vitin 2015 në Kodin e Punës dhe bazën mbi të cilën ndalohet diskriminimi e kemi zgjeruar.

Të mos harrojmë se kemi miratuar një ligj për mosdiskriminimin, duke ngritur një komision me Komisionerin për parandalimin e diskriminimit dhe në ligj baza mbi të cilën ndalohet diskriminimi është më e gjerë. Nga ana tjetër, ne jemi anëtarë të OSBE-së, dhe po të shohim rekomandimet e fundit të OSBE-së motivet mbi të cilat ndalohet mosdiskriminimi janë shumë më të gjera sesa motivet që parashikonte Kushtetuta e vitit 1998-s. Pse ndodh kjo? Kjo ndodh, sepse kanë evoluar praktikat, kanë evoluar zhvillimet në Europë e më gjerë dhe, për rrjedhojë për shkak të ratifikimit të disa marrëveshjeve që Shqipëria ka bërë dhe që Gjykata Kushtetuese nuk i ka vlerësuar në kundërshtim me Kushtetutën, ne duhet që këtë paragraf, pikën 2 të nenit 18 ta sjellim në harmoni me të gjitha konventat: me Konventën Europiane, me protokollin shtesë dhe konventat e tjera të Kombeve të Bashkuara.

Neni 6, që ju e theksoni, lidhet me ekstradimin dhe kjo lidhet me reformën në drejtësi. Pjesë e reformës në drejtësi është edhe ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale. A e pranojmë ne urdhrin europian të arrestit? Konventat në lidhje me ekstradimin i kemi ratifikuar? Në vitin 1998, kur është miratuar Kushtetuta, ne nuk i kemi pasur konventat e ratifikuara dhe pjesa më e madhe e tyre në fushën e bashkëpunimit penal ndërkombëtar janë, pasi Shqipëria ka ratifikuar një pjesë të mirë të këtyre konventave.

Neni 7 është i lidhur drejtpërdrejtë me reformën në drejtësi, me reformën që do të bëjmë në drejtësinë penale, civile dhe administrative. Më lejoni t'i referohem analizës të sistemit të drejtësisë që kanë bërë ekspertët e nivelit të lartë. Në pjesën e analizës, konkretisht në këtë moment nuk më kujtohet faqja, është analizuar si një nga mangësitë që ka sistemi i drejtësisë, që ka kosto, harxhon kohë, energji për çështje të vogla civile, penale,

administrative për të cilat ka nevojë t'u japim një frymëmarrje tjetër dhe ta bëjmë drejtësinë më eficiente, më të shpejtë, me procedura më të thjeshtuara dhe më efikase.

Gjithashtu, neni 8 i ligjit për të cilin po diskutojmë është i domosdoshëm. Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës, ku në nenin 3 të Konventës theksohet interesi më i lartë i fëmijës. Ky parim, i cili është shtuar në Kodin Penal dhe në ligje të tjera nuk ekziston në Kushtetutë dhe kjo ka qenë një nga mangësitë më të mëdha. Ju mund të thoni se konventat zbatohen drejtpërsëdrejti, por për deri sa ne e kemi një parim të rëndësishëm pse të mos jetë në Kushtetutë, kur kemi nenin 54 që flet për të drejtat e fëmijëve.

Lidhur me paragrafin që ju thoni në nenin 10, ai është 100% i lidhur me reformën në drejtësi, sepse ne krijojmë konkretisht një prokurori të posaçme dhe një byro hetimi.

E fundit fare, kolegë, ju thoni se neni 11 nuk ka lidhje me reformën në drejtësi, por ai ka lidhje. Këshilli i Ministrave është i detyruar dhe ne duhet ta detyrojmë me Kushtetutë që të raportojë në Parlament, për aktet që harton në kuadër të pjesëmarrjes së Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, pra nuk jemi duke folur vetëm kur të jemi anëtarë, sepse aktualisht ju edhe unë bashkë, por edhe përfaqësues të qeverisë dhe të ministrisë e vizitojnë rregullisht Brukselin, mbajnë qëndrime, bëjnë deklarata, bashkëpunojnë me këto institucione dhe në Kushtetutë nuk kishte asnjë detyrim që ta detyronte Këshillin e Ministrave të raportonte për aktet e hartuara në kuadër të pjesëmarrjes së Shqipërisë në Bashkimin Europian apo edhe për rezoluta dhe qëndrime.

Sa herë reagoni ju si opozitë kur thuhet të vijë Kryeministri në parlament dhe të raportojë për deklaratën që bëri në Bruksel, ose ne kur kemi qenë në opozitë, por edhe sot themi të vijë Ministri i Jashtëm. A ka ndonjë gjë të keqe që ne ta rregullojmë me Kushtetutë detyrimin që Parlamenti të jetë i informuar në mënyrë të rregullt, për të gjitha qëndrimet që mban Këshilli i Ministrave?

Ndërsa, në lidhje me 4 nenet e tjera, siç edhe jua thashë nuk flas dot, sepse është një qëndrim që e kanë përzgjedhur ekspertët e nivelit të lartë dhe mund t'u bëni pyetje atyre, ose kur t'i diskutojmë nen për ne mund t'u parashtrijmë pyetje.

Faleminderit!

Fatmir Mediu – Për procedurë, që të jemi sa më racionalë. Ne mund ta dëgjojmë gjithë ditën njëri-tjetrin dhe të përpiqemi t'i bëjmë oponencë mendimit të njëri-tjetrit. Ajo çka ne shtruan këtu ka të bëjë me specialistët që janë të pranishëm, të cilët mundësisht të japin një përgjigje për këtë shqetësim që ne ngremë si opozitë. Pra, sa me vend e gjeni nëse duhet apo nuk duhet parashikuar, sepse po t'i hyjmë analizës nen për nen, ne mund të kemi

gjykimet tona për çdo nen. Ne kemi bindjen se jemi nxituar disi, sepse një pjesë e tyre nuk hyn në reformën në drejtësi dhe në raport me opinionin publik me të cilët duhet të jemi seriozë, sepse pa hedhur një hap përpiqemi që ta shkruajmë në Kushtetutë. Pra, duhet të presim një përgjigje nga ekspertët dhe më pas të bëhet diskutimi nen për nen.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

A ka ndonjë koment tjetër?

Po, zoti Rainer.

Rainer Deville – Ka pasur një arsye përse këto dispozita janë përfshirë në draft pasi rezultati duhet të jetë hapja e bisedimeve për praninë. Ky është *backgroundi* politik. Ajo që është përfshirë këtu është pjesë e verifikimit. Ju duhet të bindni jo vetëm Komisionin Europian por çdo shtet anëtar. Është shumë e rëndësishme që ju si vend kandidat ta merrni seriozisht punën që bëni. Është ide e mirë për të përfshirë pjesët e nevojshme. Pjesët që ju shihni këtu janë dukshëm të nevojshme për procesin e zbatimit, bisedimeve për anëtarësim dhe verifikimin. Gjithsesi, këto duhet t'i kenë. Në qoftë se vendosni t'i fshini, mund të bllokoni këtë moment politik dhe hapjen e bisedimeve për anëtarësim, risk i cili nuk duhet marrë.

Arsyeja e dytë se përse është e nevojshme është për implementimin e legjislacionit. A keni gjithmonë një shkallë apelimi? Ka disa çështje teknike që duhet të bëni në lidhje me drejtësinë penale, ekstradimin, urdhrin europian të arrestit. Pra, keni një problem kushtetues. Ajo që mund të bëni teknikisht është që në nenin 179, pika 10, aty keni parashikimin që do të hyjë në fuqi vetëm pas hyrjes në BE. Ndoshta këtu mund të shtoni nenin 2, paragrafin 4. Në qoftë se do të vazhdoni në këtë mënyrë atëherë duhet ta bëni të dukshëm vizionin. Nëse ju nuk keni këtë vizion atëherë mendoj se unë mund të largohem sot, pasi nuk është më misioni i Bashkimit Europian. Mendoj se duhet të tregoni sa më shumë angazhim. Besoj se nuk doni t'i ktheheni këtij procesi përsëri, dhe aq më tepër të ndryshoni Kushtetutën çdo vit.

Është e vërtetë se do të ketë një proces verifikimi dhe çdo detaj i legjislacionit do të rishikohet. Nuk keni opion tjetër, ose keni një dritë jeshile për të gjitha, dhe ndoshta në mbrojtjen e të dhënave apo standardet mjedisore do duhet të ndryshoni diçka në Kushtetutë përsëri. Është e qartë se çfarë duhet të përfshini dhe tani thoni se nuk doni të përfshini as vlerat europiane?! Mendoj se do të ishte zgjidhje jo e mençur. E kemi përfshirë pasi ky është vizioni për t'u bërë pjesë e Bashkimit Europian. Ju sugjeroj të mos e fshini këtë vizion. Në fund të fundit është vendimi juaj politik, por nuk e di cili do të ishte impakti. Këto janë standarde europiane dhe janë të përfshira dhe në pesë prioritetet kyçe. Nuk mendoj se doni të merreni me pesë prioritetet kyçe. Është standard europian dhe ndërkombëtar dhe duhet ta

merrni në konsideratë. Gjithsesi mbetet vendimi juaj politik. Mund ta shtyni por mund të krijoni një pengesë më vonë. Do të sugjeroja që me anë të një pyetjeje teknike të shtoni nenin 2, pika 4, në nenin 179, pika 10.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zoti Strazimiri.

Gent Strazimiri – Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegia Hysi, listoi një sërë arsyesish dhe dispozitash, të cilat neve nuk na pengojnë t'i japim prevalencën e të drejtës kombëtare, të drejtës europiane dhe çdo të drejte tjetër në marrëveshje, deri tani e kemi respektuar pa pasur nevojën që të bëjmë këtë ndërhyrje në Kushtetutë. Kjo do të thotë që vakum dhe domosdoshmëri, pra as nevojë për këtë pjesë në Kushtetutë, ne nuk kemi. Pyetja që unë ngre është se përse duhet ta denatyrojmë Kushtetutën që sot deri në kufijtë e qesharakes pa qenë nevoja? Për mendimin tim kjo është një e keqe e madhe. Në bisedimet që kemi pasur edhe jozyrtarisht me kolegët, në një farë mënyre arsyen se përse i mbështesin një pjesë e tyre këto nene të Kushtetutës (për mendimin tim mund të jenë një preambulë shumë e mirë, por jo nene të Kushtetutës, të paktën në këtë fazë ku jemi), e justifikojnë me faktin që ne një ditë do të hyjmë në Europë dhe këto do të na duhen, gjithsesi. Çfarë do të bëjmë, do të ndërhyjmë përsëri në Kushtetutë? Siç i shoh unë këto nene të bëra sot, të nesërmen e ditës që do të hyjmë në Europë, do të ndërhyjmë prapë në Kushtetutë, minimalisht për të hequr te shprehja Republika e Shqipërisë pas anëtarësimit, fjalën “pas anëtarësimit”, kudo ku është e shkruar. “Republika e Shqipërisë si anëtare e Bashkimit European...”. Republika e Shqipërisë si anëtare e Bashkimit European merr përsipër...

Fatmir Xhafaj – Janë çështje gjuhësore.

Gent Strazimiri – Ndërkohë, do të mblidhemi përsëri formalisht për të hequr shprehjen: “pas anëtarësimit”. Vendosja e shprehjes: “pas anëtarësimit” është edhe logjike, është edhe e logjikës juridike, është një aspiratë, e cila zë vend në preambul, nuk mund të jetë në Kushtetutë. E vetmja gjë që më mbetet dyshim dhe që do t'i drejtohem përsëri ekspertit për të më ndriçuar është të di nëse na ndihmon kjo për të përshpejtuar anëtarësimin në Europë, në hapat që ne do të marrim, në standardet që do të bëjmë? Kjo që po bëjmë ne sot, a është një nga standardet? Vetëm në këtë rast do të na shpejtonte. Që nga viti 1992, pas rënies së komunizmit, Bashkimi European është zgjeruar disa herë. Atëherë, unë doja të dija se cilat prej vendeve anëtare, kur kanë qenë kandidatë e kanë bërë këtë ndërhyrje në Kushtetutë, sa kohë përpara dhe sa i ka ndihmuar kjo gjë? Përndryshe, unë mendoj se është absolutisht e panevojshme, joproductive, e denatyrton Kushtetutën. Këtë gjë që duhej të ishte

si aspiratë në preambul, nuk mund ta vësh në nene. Sipas mendimit tim, shpjegimi që ta vendosim, nuk mund të jetë thjesht: “Hë, se nuk prish punë”.

Fatmir Xhafaj – Zoti Rainer.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Rainer Deville – Para se të mund të anëtarësoheni në Bashkimin Europian, duhet ta keni të amenduar. Procesi i verifikimit nuk ju lejon që mos ta keni bërë. Nëse nuk e keni bërë, atëherë nuk përmbushni kriteret e procesit të verifikimit dhe negociatat do të hapen me nenet 23 dhe 24, që kanë të bëjnë me gjyqësorin, legjislacionin, urdhrin europian të arrestit, Parlamentin Europian. Pra, këto gjëra duhet t’i keni. Sigurisht është vendimi juaj nëse doni t’i bashkoheni Bashkimit Europian dhe kohën se kur. Nëse doni që ta bëni shpejt dhe të tregoni angazhimin tuaj politik për ta bërë, atëherë duhet të merrni një vendim politik dhe të amendoni atë çka duhet bërë. Sigurisht që ju mund të vendosni ta bëni më vonë dhe e bëni në një fazë tjetër. Kjo mund të vonojë procesin derisa të bëni amendimet. Nuk ekziston mundësia që të jeni pjesë e Bashkimit Europian pa përmbushur kriterin e verifikimit. Në rastin e Shqipërisë, mund të ndodhë që kapitujt e tjerë nuk do të hapen, derisa të përmbushen këto kriteret. I gjithë procesi do të vonohet nëse ju vendosni ta shtyni për më vonë dhe kjo mund të krijojë pengesa lidhur me zbatimin e legjislacionit. Ky është vendimi politik që duhet të merrni. Ne kemi pasur idenë se Shqipëria donte ta bënte sa më shpejt për të lehtësuar sa më shumë procesin e verifikimit. Ky është opsioni për ta bërë. Ju nuk keni nevojë ta bëni atë tani, nuk keni nevojë ta bëni fare, nuk keni nevojë të hyni në Bashkimin Europian tani, ky mbetet vendimi juaj. Por, në kuptimin teknik, nëse doni të anëtarësoheni, nuk mund të shmangni procesin e verifikimit. Sigurisht që ju mund të thoni që të prisni deri në momentin e fundit pasi mund të ketë nevojë për ndryshime në dispozita të tjera të Kushtetutës, por nuk mund ta parashikojmë këtë tani. Por tani mund të parashikojmë që këto dispozita janë të domosdoshme për t’u përmbushur. Teknikisht nëse nuk e doni, kjo çështje mund të adresohet tek neni 179 dhe thjesht të thoni që kjo dispozitë hyn në fuqi vetëm pas anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Ky është vendimi juaj politik. Së fundmi, nëse doni të anëtarësoheni duhet ta keni përpara se anëtarësimi të jetë i mundshëm.

Fatmir Xhafaj – Do të bëjmë pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Gent Strazimiri - Unë përsëri nuk e mora përgjigjen në lidhje me faktin se kur e kanë bërë vendet anëtare dhe sa i ka ndihmuar. Di t’ju them, të nderuar kolegë, se Republika e Shqipërisë, që nga qershori i vitit 2009, ka dorëzuar aplikimin për anëtarësim, si dhe për vendin kandidat, të cilin e ka marrë, ka një korrespondencë me letra për kriteret standarde.

Vullneti është shprehur nga Parlamenti shqiptar, nga qeveria shqiptare, madje është rikonfirmuar edhe nga qeveria pasardhëse. Në të gjitha letrat dhe korrespondencat që Republika e Shqipërisë ka deri sot me Bashkimin Europian nuk është kriter. Nëse do të ishte kriter, sigurisht që do ta zbatonim.

Pyetja që bëra ishte: kur, në cilin moment e kanë bërë këtë gjë vendet e tjera anëtare dhe sa i ka ndihmuar kjo në proces? Sot, dhe këtë e them me bindje, në korrespondencën që Republika e Shqipërisë ka me Bashkimin Europian kjo nuk është një nga kriteret, kjo nuk është një nga standardet. Do të jetë në një të ardhme. Kur? Pasi do të jenë hapur negociatat, pasi të ketë mbaruar raundi i parë, i dytë, i tretë i negociatave? Këtë nuk e di. Kur të jetë thjesht akt formal anëtarësimi, ndoshta po, por sot nuk është.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Do të kemi rast t’ia bëjmë pyetje dhe delegacionit të Komisionit Europian. Ambasadorja do të jetë këtu dhe do t’i bëjmë pyetje.

Eduard Halimi – Shqetësimi ynë nuk ka të bëjë fare me “më duket se po diskutohet tani jo qëllimi, jo integrimi”. Qëndrimet e partive politike për integrimin janë 100% për integrimin, nuk ka pasur ndonjëherë dhe nuk ka dyshim për këtë. Shqetësimi ynë është vetëm një: përfshirja në këtë moment e këtyre dispozitave, mos ndoshta është nonsens? Për hir të së vërtetës, ne nuk kemi hulumtuar, por, nëse ju na thoni se Kroacia, Bullgaria, Rumania e kanë bërë këtë gjë para negociatave, e kanë bërë edhe vendet e tjera në këtë mënyrë dhe kjo që po bëni ju nuk është nonsens, atëherë ne do ta shohim. Ky është shqetësimi, se më duket po amplifikohet diçka. Ky është shqetësimi. Mos ndoshta po shkruajmë diçka që është nonsens dhe kur të dalim jashtë të thoni: po këta çfarë po shkruajnë? E thashë edhe në fillim, nëse ju thoni se kështu e ka bërë ky apo ai vend, atëherë vazhdojmë më tej. Nëse disa nga dispozitat kanë shprehjen “pas anëtarësimit”, ju thoni: shikoni dispozitën 56, po e marr si shembull që flet “pas anëtarësimit” për bankën, atëherë kjo gjë mund të bëhet më vonë.

Pastaj po u morëm me politikë, nuk mbarojmë as për 10 vjet. Por ne këtë gjë duam nga ju ekspertët: cili vend e ka bërë? Na tregoni modelin dhe ne vazhdojmë. Ky është shqetësimi.

Fatmir Xhafaj – Ju kërkoj ndjesë, kjo është një pyetje e përsëritur. Zoti Vasili ka të drejtë që është një pyetje e përsëritur, por, gjithsesi, unë do e kërkoja mirëkuptimin tuaj për ta rikonfirmuar edhe një herë se cili është këndvështrimi juaj për këtë gjë.

Rainer Deville – Duhet ta bëni përpara anëtarësimit. Nuk mund të anëtarësoheni pa pasur gjithë procesin e verifikimit. Lidhur me kohën se kur do ta bëni gjatë procesit të negociatave, mbetet vendim politik. Ka qenë ndryshe për çdo shtet anëtar pasi kjo është pjesë

e procesit të verifikimit që gjendet brenda kapitujve. Varet nga ecuria e negociatave të secilit shtet, por që sigurisht duhet ta keni para anëtarësimit, në mënyrë që të shpejtoni procesin e anëtarësimit dhe kjo nuk është nonsens, pra ndryshoni Kushtetutën tani dhe i tregoni Bashkimit Europian se e keni përmbushur këtë detyrë. Kjo është një ide e mençur. Nëse nuk e bëni tani, duhet ta bëni më vonë. Në lidhje me monedhën Euro ka disa vende të cilat nuk përdorin Euron por nëse zgjidhni të përdorni Euron do duhet të bëni ndryshimet kushtetuese. Mendoj se Euro është një opsion real duke qenë se disa pagesa llogariten në euro. Është një vizion real për të parashikuar Euron. Kjo ndoshta është një arritje afatgjatë, dhe është vizioni juaj sa larg dhe sa shpejt doni të arrini. Të tjerat duhet t'i keni para anëtarësimit, jo pas. Gjithçka varet nga ju se kur duhet ta plotësoni këtë detyrë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Unë do të doja të theksoja një detyrim që kemi në kuadër të zbatimit të Traktatit të Lisbonës, i cili ka ndryshuar në mënyrën e qasjes së vendeve kandidate për hapjen e negociatave dhe përafrimin e legjislacionit me vendet e tjera që kanë vepruar në kuadër të Traktatit të mëparshëm të Amsterdimit.

Kolegë, ne nuk jemi vend anëtar i Bashkimit Europian, por kemi disa vjet rresht, të paktën ne që jemi në këtë Komision të Ligjeve, kur diskutojmë projektligjet, i kemi të shoqëruara me një tabelë përafrimi të legjislacionit. Për shembull ne kemi ndryshuar shumë edhe ligje të tjera edhe Kodin Doganor. Themi se ne po bëjmë transpozim të depozitave, pra po i marrim dispozitat, direktivat e BE-së dhe po i përafrojmë me legjislacionin tonë, po i marrim copy paste madje, sepse ne duhet të fillojmë ta përfarojmë legjislacionin para se të bëhemi vend anëtar. Po të shikoni...

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Zoti Strazimiri, ndjesë, unë do të pranoja të bënim debat politik ditën e enjte në seancë, por tani po flasim për Kushtetutën.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, merreni me qetësi!

Vasilika Hysi - Ju lutem, a mund të mbaroj? Ju dëgjova, ju lutem, dhe nuk ju ndërpreva. Po flasim për ligjin bazë dhe nuk do të lejoja kërkënd që kur flasim për Kushtetutën, të bëjnte politikë, sepse është ligji bazë i këtij vendi, është shtylla ku ndërtohen të tre pushtetet, e gjithë të tjerat pas. Prandaj, unë po ju them një përvojë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, lëreni të flasë zonjën Hysi!

Vasilika Hysi – Nuk është absolutisht qesharake të njohësh vlerat evropiane, sepse që kur nënshkruam MSA-në, ose që nga viti 2009, që e përmende ti, e në vijim, ne në të gjithë hapat që po bëjnë për përafrimin e legjislacionit dhe ngritjen e institucioneve në Shqipëri veprojmë sikur jemi një vend anëtar. Legjislacionin po e përafrojmë me direktivat e BE-së.

Ju lutem, të mbaroj unë, pastaj flisni! Do t'ju jap argumentin dhe nenet 121 dhe 122 të Kushtetutës, për epërsinë e akteve.

Pra, ne kemi filluar një praktikë që po i paraprin hapjes së negociatave dhe anëtarësimit duke përafuar legjislacioni. Kjo është një gjë e mirë që po bën jo vetëm Shqipëria, e ka bërë Kroacia, Sllovenia, po e bën Maqedonia dhe Mali i zi. E para.

E dyta, po e theksoj edhe një herë, zoti kryetar, të gjitha këto nene që janë këtu, ne po i zbatojmë. Pse po i zbatojmë? Jua thashë, në procesin ligjvënës, në procesin e diskutimeve ku ne përgatitemi për hapjen e negociatave, në të gjitha raportimet që bëjmë në Bashkimin Europian....

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Kolegë të opozitës, ju thatë se nëse citojmë detyrimet që ka Shqipëria për integrimin evropian si denatyrim të Kushtetutës, kjo është gabim.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Kolegu Strazimiri tha që po referuat këto gjëra, ky është një denatyrim. Unë mendoj se këto dispozita nuk janë kredo politike as për PS-në, as për PD-në. Sot ne i marrim dispozitat dhe direktivat e Bashkimit Europian fjalë për fjalë dhe i fusim në ligj, apo jo? Po ta marrësh nga ana e Kushtetutës, nuk e kemi me detyrim. Por a përgatitemi më mirë për t'u anëtarësuar? Po, përgatitemi më mirë. Atëherë, pse të mos i themi referimet?

Por ka një gjë, zoti kryetar, shqetësimi që ngriti zoti Strazimiri te neni 4, ku thuhet “pas anëtarësimit”, lidhet me çështjen e përkthimit, se këtu thuhet: “Republika e Shqipërisë me anëtarësimin në Bashkimin Europian”. Pra, këto janë çështje redaktoriale. Po u rregullua ajo, kuptohet shumë mirë.

Fatmir Xhafaj – Ju lutem, fjalën e ka zoti Vasili.

Petrit Vasili – Unë mendoj se për të ecur më përpara në diskutimin e këtyre çështjeve, për të cilat ne u referohemi ekspertëve të huaj që janë këtu, kur kemi përgjigje që janë shteruese, zoti Rajner dha një përgjigje shteruese për këtë çështje, besoj se ne nuk kemi se çfarë të diskutojmë më, ose nuk kemi pse i pyesim ekspertët dhe vazhdojmë të bëjmë debate pa fund: po apo jo. Përgjigjja e zotit Rainer ishte shumë e qartë: është e dobishme që ky lloj ndryshimi të jetë këtu. Unë besoj se këtu në këtë pikë, të paktën mund të bëhemi

ekonomikë në kohë dhe në ecjen përpara, mund të kemi debate për gjëra të tjera, por të ndalemi vetëm këtu është fare e pavend.

Edhe diçka tjetër, a është kjo e dobishme apo jo për procesin? Këtë më mirë se zoti Rainer nuk mund ta thotë njeri tjetër në këtë tavolinë. Na e tha në mënyrë të qartë që është një gjë e dobishme që duhet ta keni sot. Hajdeni të qëndrojmë këtu dhe të mos bëjmë didaskalira të tjera!

Fatmir Mediu – Unë besoj se ky diskutim për të treguar sa proevropiane është njëra palë dhe sa joevropiane është tjetra palë është pa vlerë. Kjo është nonsens. Zoti Halimi e ngriti këtë shqetësim...

Fatmir Xhafaj – Nuk e tha njeri këtë, të paktën, mos spekulohet.

Fatmir Mediu – Zoti Halimi e ngriti shqetësimin nga pikëpamja a është pjesë e reformës së drejtësisë dhe a është e vlefshme? Po flasim si kolegë me njëri-tjetrin dhe duke respektuar mendimin. Ne po themi: këtë rezervë tonën a duhet ta vlerësojmë seriozisht me njëri – tjetrin për të qenë seriozë? Nëse ju keni bindjen dhe ekspertët kanë bindjen se kjo është gjëja më e mirë, atëherë të vazhdojmë procesin, por e kemi nen për nen. Mos t'i bëjmë gjëra që nuk duhet njëri- tjetrit për dashurinë për Europën ose mos dashurinë për Europën! Është pa sens. Le të kalojmë te diskutimi nen për nen!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Nga ana procedurale, besoj se ndërhyrjet e kolegëve e qartësuan këtë çështje, kështu që mund të vazhdojmë nen për nen.

Neni 1. A jeni dakord?

Pandeli Majko – Nëse për nenin 1 jeni vetëm për “vlerat evropiane”, besoj se jemi anëtarë të NATO-s dhe duhet “vlerat atlantike”

Oerd Bylykbashi – Në momentin kur të jemi afër...Do të bëj pyetje për nenin 1.

Fatmir Xhafaj – Unë them që të mos merremi fare me preambulën. Ta heqim këtë pjesën e preambulës se është një diskutim i madh dhe do të kërkojë shumë kohë.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Vazhdojmë me nenin 2. A jeni dakord me rregullimin e shprehjes “me anëtarësimin në Bashkimin Europian”?

Pandeli Majko – Unë jam kundër. Me gjithë respektin që kam për zotin Rainer, mendoj se neni i formuluar në këtë pikë, në këtë mënyrë, më tepër ka karakterin e një norme juridike dëshpëruese. Unë nuk di të ketë ndonjë eksperiencë ku ndonjë Kushtetutë e një vendi të shkruajë një nen pritshmërie. Do të ishte e mirë që qëllimi i njëjtë i Shqipërisë karshi Bashkimit Europian, mbase do të kërkonte një riformulim të paragrafit të tretë të nenit 2, pasi

paragrafi i tretë duket shumë qartë që është i vjetër në mënyrën e formulimit të tij. Po e citoj: “Për ruajtjen e paqes dhe të interesave kombëtare, Republika e Shqipërisë mund të marrë pjesën në një sistem sigurimi kolektiv”. Është paragraf, i cili vazhdon: “në bazë të një ligji të miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit”. Ky paragraf është shumë i qartë, është bërë përpara integrimit të Shqipërisë në NATO. Por sigurisht interesat kombëtare të Shqipërisë nuk janë thjesht të lidhura dhe vetëm me paqen, por janë të lidhura edhe me intensionin e saj për integrimin dhe procesin e integrimit në Bashkimin Europian. Prandaj do të thosha që një riformulim që shpreh atë që ka ndodhur nga pikëpamja e sigurisë dhe intensionin e shtetit shqiptar për procesin e integrimit europian dhe vlerat europiane, do të ishte më i plotë.

Unë nuk kam ndonjë gjë të gatshme, por mendoj se kjo do të ishte shumë më e qartë për sa i përket edhe asaj që diskutuam deri tani.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Kam vetëm një gjë, që duhet të jetë e qartë për të gjithë. Këtu nuk kemi ardhur për të shqyrtuar Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Në qoftë se keni ndonjë gjë, që duhet të shqyrtoni Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, drejtojuni parlamentit, ngrini një komision dhe le të bëjmë propozime. Këtu kemi një projekt që e kanë sjellë ekspertët. Nëse biem dakord, i kundërshtojmë. Shprehim vullnetin politik, vizionin, konceptin dhe qëndrimin tonë. Pjesa tjetër pastaj janë improvizime.

Kështu që duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Në qoftë se keni ndonjë gjë me propozimin e sjellë nga ekspertët, kush do që ta votojë kundër, le ta votojë kundër, kush do që ta votojë pro, le ta votojë pro. Kjo është logjika që kam.

Këtu nuk jemi mbledhur të lexojmë Kushtetutën dhe të themi që shiko unë jam dakord me këtë nen ose nuk jam.

Pandeli Majko - Si kolegu juaj, edhe unë mendoj që nuk jemi mbledhur këtu për të diskutuar dhe vendosur thjesht dhe vetëm për propozimet që janë të shkruara nga ekspertët. Ne jemi një trupë e autorizuar nga parlamenti për të diskutuar me detaje të gjitha ato që ne kemi përballë nesh si dokumente të përgatitura nga ekspertët.

Mendoj se në këtë pikë diskutimi nuk mund të kornizohet nga fakti se çfarë kemi të shkruar në letra. Në fund jemi ne autoriteti fundor i autorizuar nga parlamenti për të vendosur lidhur me ato çfarë diskutohet.

Mendoj se diskutimi duhet të ecë jo thjesht nëse ne jemi ose jo dakord me atë çfarë është shkruar në letër, por të jetë pak më i thelluar, sepse, në fund të fundit, ne nuk jemi

thjesht dhe vetëm për të thënë po ose jo, por për ta diskutuar në esencë të gjithë këtë çështje kaq të rëndësishme.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Urdhëroni!

Vasilika Hysi – Paragrafi 4, që i shtohet nenit 2, zgjidh shqetësimin e kolegut Majko. Republika e Shqipërisë me anëtarësimin në BE është e deleguar të lëshojë nga pjesa e sovranitetit të saj dhe u delegon institucioneve të BE-së në fushën e sigurisë, ekonomisë një pjesë të kompetencave.

Edhe siguria në kuadër të integritetit evropian e rregullon më së miri shtesën që bëhet në nenin 2 të projektit. I vetmi shqetësim, zoti Xhafaj, është ajo që ju thatë, që do të themi: “Me anëtarësimin në BE, Republika e Shqipërisë i delegon institucionit të saj pushtete të nevojshme”, siç i kanë deleguar të 28 vendet anëtare të BE-së.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Jemi dakord me nenin 2? Kush është kundër? Nuk ka.

Faleminderit!

Neni 3. Në nenin 6/1 pas fjalës “ ndalohet” shtohen fjalët “ për një kohëzgjatje të caktuar”.

Ka komente? Zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Do ta nis me një pyetje, për të cilën dua një përgjigje nga ekspertët. Pastaj do të flas për nenin.

Neni 6/1, të nderuar kolegë, e dini që u miratua në datën 17 dhjetor me një marrëveshje të përbashkët, me një punë disajvare dhe me bindjen e plotë që po bënim atë që duhej.

Ndryshimi në nenin 6/1 ishte me qëllimin për t'i hapur rrugën ligjit “Për dekriminalizimin”, i përshëndetur fort nga Sekretari i Shtetit, Kerry; nga përfaqësuesja e lartë e BE-së, Mogherini dhe i kërkuar për zbatim edhe nga komisioneri Hahn.

Pyetja ime është: Cili e autorizoi përfshirjen në draftin e janarit, që iu dërgua Komisionit të Venecias, nenin ekzistues, prej vetëm pak javësh të miratuar, as 3 javë ndoshta, për opinion? Është bërë nga ekspertët apo ka pasur autorizim politik? Dua ta di përpara se të jap mendimin tim.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Pyetja nuk është shumë korrekte, megjithatë, është e drejta juaj të pyesni. Merreni me qetësi, sepse as ju nuk keni pronësinë e dekriminalizimit dhe as ne nuk kemi pronësinë e Kushtetutës.

Zoti Bylykbashi, unë po jap mendimin tim që nuk do të ishte shumë korrekte t'ua drejtonim këtë pyetje ekspertëve. Megjithatë, është e drejta juaj. Ju keni të drejtën të pyesni dhe ata kanë të drejtën të përgjigjen në mënyrën si e gjykojnë të arsyeshme.

Ju lutem, kush nga ekspertët do të japë një përgjigje për këtë çështje, për pyetjen e zotit Bylykbashi?

Jon Smibert – Kjo është një pikë interesante pasi askush nga Shqipëria nuk kërkoi mendimin e Komisionit të Venecias. Ata e përfshijnë vullnetarisht në opinionin final, në paragrafin 74. Kjo nuk ishte parashikuar, ishte diçka *sui generis* në opinionin e tyre. Ne na u kërkua që të reflektonim opinionin dhe ky ishte një paragraf i opinionit. Ne thjesht bëmë rekomandimin në lidhje me atë që tha Komisioni i Venecias. Ne thjeshtë po adresojmë ato që Komisioni i Venecias ka thënë.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit!

Pra, nga përgjigja unë kuptova që drafti i janarit nuk e ka të përfshirë nenin 6/1. Ju keni marrë për detyrë të reflektoni opinionin final të Komisionit të Venecias.

Kështu që unë do ta verifikoj me draftin nëse komisioni e ka dërguar këtë gjë.

Tani kthehemi te çështja. Neni 6/1 është një nen, i cili është bërë me punë të përbashkët, me konsultim dhe me përpjekjen për ta bërë sa më të përmbledhur. Opsioni ka qenë për një nen edhe më të gjatë se ky, në mënyrë të qëllimshme për të ruajtur edhe teknikën që ka kjo Kushtetutë, por kjo nuk është e rëndësishme.

Është një nen që reflektonte vullnetin politik maksimal për të ndryshuar edhe Kushtetutën, që zyrtarët më të lartë të shtetit të mos përdornin Kushtetutën si arsye, për të mos u larguar nga funksioni apo për t'u penguar në të ardhmen.

Nëse kjo dispozitë do të miratohet me këtë propozim, gjëja e parë që ne duhet të bëjmë, përveçse po thyejmë një marrëveshje politike, përveçse po ndryshojmë një nen, që ka vetëm pak muaj, që është miratuar, por në momentin kur është dërguar eventualisht për opinion, kishte vetëm dy ose tri javë, ne do të ndryshojmë menjëherë edhe ligjin "Për dekriminalizimin".

Në vend që kriminelët për krime të rënda, siç ramë dakord të gjithë, të pengohen për jetë, do t'ua bëjmë më të shkurtër pengimin. T'u japim mundësinë pse jo, të marrë funksione dikush që ka vrarë në vitin 1989, dhe sot të jetë një nga zyrtarët më të lartë të shtetit shqiptar, aq më keq po të ketë vrarë për arsye që të gjithë shqiptarët nuk e pranojnë. Pra, nuk është vetëm histori korrupsioni, por është për krimet e rënda.

Po ashtu, Komisioni i Venecias në paragrafin 74, flet vetëm për tendencë, që do të thotë se nuk është normë që këto lloj kufizimesh të jenë të rralla, pra, që kufizimet për jetë të

mos jenë. Komisioni i Venecias, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut e pranojnë mundësinë për një diçka të tillë, dhe ndërhyrja është në proporcion edhe me rrethanat me të cilat po operohet, por rrethanat e Shqipërisë ishin të tilla që na detyruan të miratojmë ligjin “Për dekriminalizimin”, sepse unë besoj se do të ishim njëqind herë më të nderuar po të mos kishim fare nevojë, por sot na e kërkon BE-ja dhe SHBA-ja ta zbatojmë. Kjo do të thotë që situata është e rëndë dhe një situatë të rëndë u përgjigjen instrumentet e forta kushtetuese dhe ligjore.

Kushtetuta, e shkruar siç ishte, nuk bënte asnjë lloj pengese. Interpretimi i paragrafit 74 të opinionit krijon pengesë në zbatimin e ligjit, siç është, vetëm pak muaj nga miratimi dhe vetëm pak ditë nga fillimi i procedurave për zbatimin e ligjit.

Kështu që bindja ime është se kjo ndërhyrje është e panevojshme madje penguese dhe është një interpretim shumë i zgjeruar i asaj që thotë Komisioni i Venecias, që flet vetëm për një tendencë dhe jo për një normë apo një detyrim të pakapërcyeshëm.

Kështu që unë ju ftoj që ky ndryshim që bëhet te neni 6/1 të mos votohet nga komisioni, sepse do të ishte jo vetëm cenimi i gjithë kësaj çfarë thamë, por do të ishte edhe një tregues i një kthimi mbrapsht në vullnetin që më 17 dhjetor të gjithë ne treguam që kriminelët, që kishim në parlament që eventualisht janë aty, ata që janë në administratë dhe që do të dalin gjithmonë e më tepër, ata për krime të rënda, të kenë mundësinë më të mirë se sa e kanë me ligjin e dekriminalizimit sot. Unë nuk besoj se e mban ndokush këtë barrë, të paktën ju krahu këtej. Besoj edhe ju, sepse bashkë e votuam më 17 dhjetor.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Dakord.

E para, dua të them se nuk ka qenë në projektin e janarit.

E dyta, ata janë ekspertë dhe me këndvështrimin e një eksperti kanë zbatuar opinionin final të Komisionit të Venecias. E keni të shkruar në paragrafin 74.

E treta, kjo është një çështje që duhet parë jo me emocion politik, por duhet parë nga këndvështrimi kushtetues. Të mos mundohemi ta mundim me argumente politike, sepse po të jetë me pozicionin amerikan apo të Komisionit Europian nuk ata kanë interes të ndryshëm nga ne qoftë për procesin e dekriminalizimit, qoftë për këtë proces. Përkundrazi, kemi interesa të njëjta dhe këndvështrime të njëjta nga pikëpamja e efektit që ka. Këtu është fjala për të parë një pozicion strikt në përputhje edhe me konventat, sepse këto mund të jenë aspekte që nesër mund të rishikohen ose mund t’i nënshtrohen gjykimit dhe mund të krijojnë probleme. Kjo është thjesht një gjë teknike, pa konotacion politik dhe emocional, mendoj unë.

Urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, e kuptova qasjen tuaj. Unë dakord jam, sepse nuk besoj se ndokush tenton të nxjerrë kredo politike nga ky ndryshim. Kredon politike e kemi nga neni, siç është sot. Neni siç është sot lejon mundësinë që nëse nesër Shqipëria do të jetë shumë më e pastër, ligji i dekriminalizimit lehtësohet, por kjo që është sot, pra, ky propozim që bëhet, cenon pikërisht atë që kemi miratuar së bashku më 17 dhjetor 2015.

Gjëja e parë që duhet të bëjmë sapo të miratohet kjo, është të dorëzojmë ligjin “Për dekriminalizimin”. Unë e di që detyra e ekspertëve ndërkombëtarë dhe jo vetëm, është të na propozojnë, të na sugjerojnë sipas interpretimit të tyre, se si mund ta reflektojmë rekomandimin.

Unë e thashë që ky është një sugjerim, që bazohet në një interpretim shumë të zgjeruar të atij paragrafi. Nuk u vë faj ekspertëve në këtë aspekt. Detyra jonë këtu është t'i qëndrojmë asaj që kemi bërë bashkë jo vetëm në aspektin politik. Ajo që kemi bërë në është bërë e konsultuar me dokumentet e Komisionit të Venecias, që kishte nxjerrë më përpara, që ishte raporti specifik për ato çështje. Nuk kundërshtohet nga opinioni, flet vetëm për tendencë dhe nuk është ky komision më i aftë se çdo lloj strukture tjetër që ka pasur përpara ky parlament për të gjykuar që njëra është më kushtetuese dhe tjetra më pak kushtetuese. Është pjesë e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe çdo veprim tjetër e ekspozon keq këtë komision. Po kërkojmë t'ua thjeshtojmë atyre që po na çudisin çdo ditë.

Edhe një herë nuk është histori ekspertize mbi kushtetueshmërinë ose mos përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare. Ato i kemi parë ditën kur kemi miratuar nenin 6/1, i cili më pas lejon që kur ta gjykojmë se Shqipëria është bërë më e mirë, ta relaksojmë ligjin për dekriminalizimin pa prekur nenin kushtetues.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Të jemi koncizë, ju lutem! Zonja Hysi, urdhëroni!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë e falënderoj kolegun Bylykbashi që e nisi këtë diskutim për nenin 3 dhe konkretisht për shtimin e togfjalëshit “për një kohë të caktuar”.

E para, unë e quaj me vend këtë shtim, nuk e di se kush e ka bërë nga ekspertët, referuar ligjit nr. 138, që kemi miratuar në vitin 2015.

Zoti Bylykbashi, të dy bashkë dhe një pjesë e mirë të kolegëve kemi qenë anëtarë të Komisionit të Pastërtisë së Figurave, dhe kemi rënë dakord për miratimin e këtij ligji. Në nenin 4 të ligjit 138, ne kemi përcaktuar periudhën e ndalimit të kandidimit, të zgjedhjes apo të ushtrimit të funksionit të zgjedhur dhe të emëruar. Kemi dy periudha: një periudhë

për një kategori personash ndalimi është i përjetshëm dhe kjo është një kategori e vogël. Ndërsa, për një kategori veprash penale për personat e tjerë, sipas veprave penale të kryera, ndalimin ne e kemi me periudha kohore, të cilat variojnë nga 20 vjet, 10 vjet gjatë kohës së vuajtjes së dënimit e me radhë.

Me fjalë të tjera, në qoftë se do t'i hyjmë interpretimit fjalë për fjalë të togfjalëshit “për një kohë të zgjatur” shqetësimi juaj ka gjetur zgjidhje. Kohëzgjatja mund të jetë e përjetshme ose e përkohshme 2, 10, 20 vjet, siç i kemi në pikën 6 të nenit 4 të ligjit 138 që kemi miratuar së bashku.

E dyta, shqetësimi juaj gjen përsëri zgjidhje, sepse në vazhdim të fjalisë së riformulimit që i bëhet këtij neni të Kushtetutës ne kemi thënë, sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara në ligjin e miratuar me 3/5-at e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Çfarë do të ndodhte, koleg i dashur, nëse ne nuk do ta kishim këtë togfjalësh? Nëse nuk do ta kishim, fjala “ndalim” nuk bëhet e qartë që ky ndalim do të jetë për të gjithë i përjetshëm apo ka periudha të ndryshme kohore. Kur thuhet periudha të caktuara, unë mendoj se përfshihen të gjitha. Mund të ketë një riformulim tjetër, por unë do ta quaja që Kushtetuta do të zgjerohej: ndalohet përgjithnjë ose për një periudhë të caktuar kohe, por fjala “kohëzgjatje e caktuar” e mbulon edhe atë që ju thoni dhe që me të drejtë e ngrini shqetësimin “kohëzgjatje të përjetshme”.

Për ta mbyllur, kjo shtesë nuk e zbut, përkundrazi, e sjell këtë nen në përputhje me të gjitha orientimet që na dha Komisioni i Venecias, por edhe me standardet e Konventës Europiane etj.

Kështu që as ju dhe as unë nuk duhet të ndihemi të fyer. Jemi të dy anëtarë të të dy komisioneve dhe asnjë nga ne nuk ka dashur të na fyejnë inteligjencën tonë. Unë e quaj të saktë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Halimi, urdhëroni!

Eduard Halimi – Shqetësimi i opozitës për këtë nen është real. Ky nen nuk ka lidhje me reformën në drejtësi, por ka lidhje me reformën për dekriminalizimin. Ne kemi analizuar që ka modele europiane që e ndalojnë për një kohë të caktuar, ka edhe modele të tjera ndërkombëtare, që e ndalojnë përjetë dhe rasti shqiptar ishte tipik. Banditë të akuzuar për trafik ndërkombëtar, të femrave, të armëve, drogës, janë në Parlament.

Ne kemi qëndrim politik. Ata banditë edhe kur mbarojnë dënimin për gjithë jetën e tyre, nuk mund të jenë deputet në parlament.

Mark Frroku, ne i kemi pasur me emra, nuk mund të jetë më deputet për gjithë jetën. Unë e lexova nenin paragrafin 74. Komisioni i Venecias sugjeron fleksibilitet dhe unë bashkohem me shqetësimin e Oerdit. Nuk kishte pse të ishte në këtë draft, sepse ne e kemi marrë këtë vendim politik. Mund të ishte në kundërshtim edhe me dynjanë. Ka plot këtu që duan ta çojnë në Gjykatë Kushtetuese, është antikushtetuese. Ne kemi qëndrim politik. Kush do ta marrë dhe ta çojë në Gjykatën Kushtetuese, mund ta çojë.

Komisioni i Venecias në *footnote-in* 23 i referohet Polonisë, por u referohet rasteve të lustracionit. Unë jam dakord. Rastet e lustracionit, thotë, duhet të kenë një kohëzgjatje të caktuar. Shikoni për shembull qëndrimin e tribunalit kushtetues të Polonisë që në vendimet e 11 majit 2008 shprehet se akti i lustracionit bazuar në parimet e shtetit ligjor specifikon periudhën kohore të ndalimit për kryerjen e funksioneve, sepse nuk mund të nënvlerësohet mundësia e ndryshimeve pozitive në qëndrimin e sjelljes së një personi. Masat e lustracionit duhet të vazhdojnë të jenë në fuqi sapo sistemi i një shteti demokratik të konsolidohet. Pra, është rasti i lustracionit dhe jo rasti i kandidatëve që janë aty.

Ndaj, ju ftoj të mos e vazhdojmë më këtë debat, por ta lëmë siç është ose mund të ketë ndonjë sugjerim, që ndalohet përjetë ose për një kohëzgjatje... Në qoftë se zoti Bylykbashi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Vasili, ky është një qëndrim, i cili... Ligji nuk ndryshohet. Neni 6/1 nuk ndryshohet. Ju kërkoj shumë njerëzisht në këtë komision që ta lëmë historinë e dekriminalizimit. Kur të doni, bëjmë një komision tjetër.

Zoti Xhafaj, unë e lexova vendimin e ngritjes së këtij komisioni. Ky komision nuk e ka tagrin të merret me ligjin e dekriminalizimit. Ne kemi tagrin për t'u marrë me reformën në drejtësi, me ligjet që kanë impakt të reforma në drejtësi dhe me sistemin gjyqësor. Kemi marrë vendim politik, që kush ka bërë krime të tilla, sipas Konventës së Palermos, nuk mund të jetë deputet në Shqipëri. Unë e mirëkuptoj që mund të ketë vende, të cilat e pranojnë, por ne si parlament dhe si politikanë e kemi marrë këtë vendim për gjithë jetën. Pjesa "për një kohëzgjatje të caktuar", është vetëm një dritare që mund t'u hapet atyre, sepse ligji do të jetë në kundërshtim me Kushtetutën.

Ndaj, unë mendoj ta mbyllim këtë diskutim. Po jua them se vota jonë unanime është kundër këtij neni dhe shpresoj që edhe ekspertët ta mirëkuptojnë qëndrimin tonë. Komisioni i Venecias nuk ka dhënë autorizim që të ndryshohet, por ka bërë një sugjerim, nuk ka thënë kjo është kështu dhe duhet të bëhet kështu.

Paragrafi 74 thotë: “Ne sugjerojmë fleksibilitet në zbatimin e masave”. Ne si parti politike, për banditët që janë marrë me trafik femrash, armë dhe drogë, e kemi zero fleksibilitetin. E kemi marrë këtë vendim dhe ky është qëndrimi ynë, ndaj ju ftojme të mos ecim mbrapsht.

Fatmir Mediu – Zoti Xhafaj, mendoj se gjëja më e keqe që mund të bëjmë ne si komision është të dalim nga kjo mbledhje me dy qëndrime në raport me këtë çështje. Për një gjë që kemi qenë të gjithë dakord, t’i rikthehemi shqyrtimit të asaj çfarë bëmë për dekriminalizimin, jo vetëm që nuk kemi autoritet, sepse është miratuar me konsensus të plotë në parlament, por në raportin e opinionit publik do të krijojmë një opinion që nuk duhet të jetë dhe do të ishte gjëja më e gabuar që mund të bëhej. Prandaj, do t’ju lutesha t’i shkojmë deri në fund asaj që tha zoti Halimi! Kjo ishte e para.

E dyta, pavarësisht nga diskutimet e vlefshmërisë ose jo, fakti që ndalohej për një kohëzgjatje të caktuar, një pjesë e njerëzve që përjashtohen nga ligji i dekriminalizimit, do t’i bënte që të adresoheshin te Gjykata Kushtetuese dhe kjo do ta bënte atë që kemi miratuar ne, një ligj të atakueshëm. Prandaj, do t’u lutesha edhe ekspertëve, z. Smibert dhe kujtdo tjetër, pavarësisht nga qëllimi dhe mënyra sesi është shprehur Komisioni i Venecias, se kjo nuk duhet të jetë, por jo thjesht me qëndrimin e opozitës, por edhe me qëndrimin tuaj dhe qëndrimin e maxhorancës. Do të ishte shumë problematike që ne të dalim tek opinionin publik duke ndryshuar një vendim që e kemi marrë në mënyrë unanime të gjithë së bashku, qoftë edhe të diskutohet, ka, apo nuk ka vlerë ky vendim.

Fatmir Xhafaj – Zoti Vasili, urdhëroni!

Petrit Vasili – Unë kam vetëm një pyetje, që nuk ka lidhje me dekriminalizimin. Problemi është: ne do të bëjmë një marrëveshje parimore dhe do t’i qëndrojmë, apo do të vazhdojmë në një qorrsoak? Kemi bërë një marrëveshje parimore: do t’i dëgjojmë të gjitha palët që kanë sugjerime relativisht të qarta për Komisionin e Venecias? Të gjithë kemi bërë be me të majtë dhe me të djathtë se, kur Venecia është shprehur, ne do të qëndrojmë. Mendoj të bëjmë një marrëveshje fjale, që ta dimë në qoftë se do të hapim debate, por nuk na shqetëson fare debati edhe nëse vazhdon 360 gradë, le të vazhdojë edhe 7 muaj, le të mos bëhet reforma në drejtësi, por ama, të vëmë disa kritere ku të ecim. E kemi opinionin e Venecias? Po. E kemi opinionin e ekspertëve? Po. Kemi rënë në dakordësi politike. Në qoftë se i keni të qarta, të shterojmë, sepse kështu nuk mund të bëjmë dot përpara.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ata e kanë dhënë versionin.

Ulsi Manja - Pavarësisht interpretimit që unë i bëj kësaj çështjeje, në gjykimin tim kjo e çimentos ligjin për dekriminalizimin, i jep akoma më shumë fuqi në mënyrën se si është parashikuar, por gjithsesi, unë kam një pyetje për ekspertët: në mënyrën sesi është formuluar neni 6/1, a cenohet gjëkund ligji “Për dekriminalizimin” në zbatimin e tij, që tashmë ka filluar? A ka lidhje me reformën në drejtësi? Po, sigurisht që ka, sepse edhe gjyqtarët, edhe prokurorët, janë pjesë e pastërtisë së atij ligji që kemi miratuar. Pra, a cenohet gjëkund ligji “Për dekriminalizimin” me këtë formulim që i është bërë neni 3?

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Me sa shikoj, nuk ka diskutime të tjera. Ka dy pozicione. Unë do të dëshiroja t’i dëgjoja edhe një herë përfundimisht, pasi i dëgjuam të gjitha gjykimet e bëra në tryezën e komisionit dhe, duke pasur në konsideratë opinionin e Venecias dhe sensibilitetet që janë, cili do të ishte gjykimi final, ose nëse keni një vlerësim shtesë mbi vlerësimin që bëtë fillimisht për këtë nen.

Rainer Deville – Askush nuk i kërkoi Komisionit të Venecias këtë koment. Ne thjesht e përfshimë komentin e dërguar. Mbase Komisioni i Venecias bëri këtë koment pasi kanë vënë re që ka një cenim të të drejtave të njeriut nëse diçka bëhet përgjithmonë dhe për jetë. Ky është një nga standardet e Këshillit të Evropës. Komisioni i Venecias ju këshillon të rishikoni legjislacionin. Ju mund të bini dakord pasi neni 6/1 i referohet ligjit që e zbaton atë dhe ky ligj ka nevojë të ndryshohet. Komisioni i Venecias është shprehur se nëse ka një kufizim për jetë, kjo nuk do të miratohet në Strasburg. Komisioni i Venecias shprehet se mund ta merrni këtë në konsideratë në nivel kushtetues dhe ligjor. Kjo është një vërejtje e bërë nga Komisioni i Venecias. Nëse doni ta merrni seriozisht Komisionin e Venecias, duhet që ta keni parasysh, ose mund të vendosni që të thoni që e keni parë dhe dëshironi ta diskutoni në një kohë tjetër. Duhet të keni parasysh që ky është një koment i mirëbazuar që ka ardhur dhe nëse nuk e merrni parasysh tani, mund të ketë një problem potencial në legjislacionin tuaj, për të cilin Komisioni i Venecias e ka dhënë opinionin që ka një problem.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Smibert!

Jon Smibert – Para së gjithash, dua të them që Ambasada amerikane e ka mbështetur procesin e dekriminalizimit. Kjo ishte e papritur për t’iu rikthyer dhe nuk ka qenë ndër çështjet të cilat ne dërguam në Komisionin e Venecias. Nëse e konsideroni tani apo në një diskutim tjetër, nëse besoni se ligji aktual është i mjaftueshëm, se parimet kushtetuese janë përcaktuar, nëse ndjeni se ligji në vetvete mbron në mënyrë të mjaftueshme, kjo mbetet e drejta juaj. Ne na është kërkuar implementimi i opinionëve të Komisionit të Venecias dhe kjo ka qenë një nga pikat që ata bënë duke thënë se kjo është ngritur dhe në rastin e Polonisë.

Ndërsa ishim në Venecia u përmend disa herë fakti se Komisioni i Venecias ishte shumë i kënaqur që ju keni kaluar ligjin e dekriminalizimit. Nuk besoj se ka qenë një qëndrim kritik i Komisionit të Venecias por më tepër një koment dashamirës. Ne na është kërkuar vetëm që të marrim opinionin e Komisionit të Venecias pikë për pikë dhe ta vendosim këtu. Mbetet vendimi juaj se si Kushtetuta dhe ligji do të reflektojnë këtë pikë.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit! Zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, për ekspertët, për zotin Rainer dhe zotin Smibert, unë besoj se ky Parlament e merr shumë seriozisht Komisionin e Venecias dhe ky diskutim po merret po aq seriozisht, nuk ka pikëpyetje kjo gjë. Ajo që kemi bërë dhe që e kemi sot në Kushtetutë është jo vetëm një shprehje vullneti të palëkundur politik, e tha zoti Halimi dhe kolegët e tjerë, por është bërë duke u konsultuar edhe me raportin e Komisionit të Venecias, edhe me jurisprudencën e Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut. Është pikërisht kjo arsye që ata nuk kanë detektuar shkelje të standardeve ndërkombëtare në këtë aspekt. Ata na thonë se tendenca, jo në raportin final, por në raportin për çështjen e dekriminalizimit, është që kohëzgjatja duhet të respektojë proporcionalitetin dhe, po kështu, edhe ajo ndërhyrjeje duhet të respektojë proporcionalitetin e situatës për të cilën po ndërhyjmë.

Ne nuk jemi këtu trëndafila dhe lule dhe po vëmë një ligj të tmerrshëm që nuk ka lidhje me një situatë kaq rozë. Jo, kemi atë situatë dhe ajo ndërhyrje ishte absolutisht në përputhje me situatën. Është proporcionale ndërhyrja aty. E tha zoti Halimi, nuk duam të kemi kriminelë të atij lloji, edhe ju nuk doni t'i gjeni ndonjëherë në parlament. Por dispozita kushtetuese jep edhe mundësinë, kështu siç është sot, që të ndërhyhet nesër për ta lehtësuar ndërhyrjen. Kështu që, nuk është çështje konstatimi nga Komisioni i Venecias në ndonjë shkelje. Nëse e kanë gjykuar oportune, të thonë atë që kanë thënë te paragrafi 74, sërish nuk na thonë se ka një shkelje, sepse po të kishte shkelje, nuk do të thoshin është tendencë, është në kundërshtim me filan paragraf të konventës.

Për rrjedhojë, unë besoj se e kemi shumë të mirë nenin kështu siç është, nuk ka nevojë për asnjë lloj ndërhyrjeje dhe aq më pak nuk ka nevojë për shtimin e një kushti tjetër kushtetues, e ka një kusht neni, ku thuhet: “Ndalohet”. “Shtimi i kohëzgjatjes” është kushti i dytë. Ndërkohë, kështu siç e kemi sot, me fleksibilitetin maksimal me një ligj me 3/5-at, që gjithsesi, e garanton shumica e kërkuar nga Kushtetuta, që kushtet dhe rregullat i kemi në ligj dhe atje kemi thënë: “Kriminelët për krimet e rënda përjetë dhe të tjerët me afate”. Kur të ndërrojmë mendjen ne, pa prekur Kushtetutën, edhe kur të kemi hyrë në Bashkimin Europian, mund ta ndryshojmë sërish atë gjë, kështu që besoj se ...

Zoti Mediu e shpjegoi: në qoftë se nuk ndryshon ligji, duke e kufizuar afatin ne u hapim mundësinë këtyre kriminelëve që t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për interpretim. Nëse, siç thotë eksperti, ka ndonjë që të mund të shkojë në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut për të pretenduar se ky ligj ka probleme, ndoshta ndonjë nga organizatat e të drejtave të njeriut mund t'i japë edhe konsulencë juridike për statutin e shoqatave të personave ish-politikanë të hequr nga dekriminalizimi, mund të shkojnë edhe në Strasburg, nuk ka problem për këtë çështje. Por unë nuk besoj se kjo është detyra jonë.

Kështu që, ju lutem, lëmë një nen që është maksimalisht fleksibël, i jep mundësinë legjislatorit nesër ta ndryshojë ligjin nëse çështja përmirësohet, por jo sot. Nëse vendoset një kohëzgjatje e caktuar, kriminelin i parë që ikën nga funksioni, dhe kemi të tillë, ka ikur, vetëm se dha dorëheqjen, se përndryshe do ta kapte. Nëse do të zbatohet Kushtetuta, Arben Frroku do të kishte ardhur me mandat deputeti dhe do ta kapte ligji i dekriminalizimit. Është kapërcyer Kushtetuta në mënyrë skandaloze nga KQZ-ja dhe nga parlamenti i Shqipërisë. Ai do të ishte deputet, do të ngecte në rrjetën e këtij ligji dhe, me këtë ndryshim, kishte të drejtën t'i drejtohej edhe Gjykatës Kushtetuese: më keni hequr mundësinë që ta kem me kohëzgjatje, ma keni bërë përjetë. Kështu që merreni me...

(Diskutime pa mikrofon.)

Në fakt, zotërinj, për ta mbyllur, ligjin e dekriminalizimit dhe këtë nen e kemi futur, sepse Shqipëria ka një situatë *sui generis*. Korrupsioni nuk është situatë *sui generis*, është fenomen i rëndë, por shumë i përhapur. Është i përhapur në vendet joanëtare të BE-së, shumë i përhapur edhe në vendet anëtare të BE-së. Kështu që ne luftojmë atë pjesë, por *sui generis* nuk është. Kjo është ajo që na ka bërë ne me njollë të zezë përpara gjithë shqiptarëve: kriminalizimi.

Fatmir Xhafaj – Ka diskutime të tjera?

Urdhëroni, zoti Majko!

Pandeli Majko – Unë do të vazhdoj atë që tha kolegu për situatën *sui generis*. Mendoj se në qoftë se jemi mbledhur këtu për të diskutuar me principe juridike, të diskutojmë me principe juridike, nëse jemi mbledhur për të diskutuar situatën politike në Shqipëri, të diskutojmë situatën politike, por ta ndajmë: çfarë do të diskutojmë për parimet politike, çfarë do të diskutojmë për politikën.

Meqenëse ra fjala për *sui generis*, pak më parë u diskutua raporti ynë me Bashkimin Europian. U ngritët, të nderuar kolegë të opozitës, dhe unë ju përkrah për atë që thatë, se duhet të shikohet eksperiencia e vendeve të tjera, si e kanë bërë, ku e kanë bërë e të tjera dhe na bëtë historikun e jurisprudencës, marrëdhëniet e vendeve të tjera në Bashkimin

European. Por, kur diskutoni elemente, të cilët justifikojnë qëndrimet tuaja, e përmendni fjalën *sui generis*. Nëse do të diskutojmë me *sui generis*, atëherë ta hapim pak këndin e vështrimit dhe të shikojmë se çdo Kushtetutë ka elementet e veta *sui generis* dhe kjo draft-kushtetutë ka marrë një koncept logjik që është mbi marrëveshjen e dy palëve dhe marrëveshja e dy palëve do të ecë me këtë logjik.

Ajo që tha zoti Vasili është shumë e rëndësishme, kemi rënë dakord në parim se do të diskutojmë mbi bazën e opinioneve të Komisionit të Venecias, nuk kemi ardhur të diskutojmë mbi bazën e opinioneve politike të Partisë Socialiste. Venecia ka dhënë një këshillë në këtë pikë dhe ne po diskutojmë këshillën e Venecias. Historitë se kush është burri më trim në Shqipëri kundër kriminalitetit dhe krimit të organizuar janë krejt tjetër, besoj se nuk është as vendi dhe as koha për ta diskutuar.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Smibert, urdhëroni!

Jon Smibert – Raineri dhe unë po diskutonim lidhur me interpretimin e nenit 6/1 dhe atë çka ka thënë Komisioni i Venecias. Nëse lexojmë së bashku nenet 6/1 dhe 17 mbi kufizimet bazuar në parimin e proporcionalitetit, interpretimi mund të jetë në përputhje me atë çka thënë Komisioni i Venecias, por për raste specifike do duhet të nxjerrim konkluzion ligjor.

Rainer Deville – E thënë ndryshe, ju mund të ndryshoni ligjin e zbatimit me 3/5 dhe ta bëni të qartë, që mos të jetë në kundërshtim me Kushtetutën bazuar në Komisionin e Venecias.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka gjë tjetër për diskutim? Nuk ka.

Besoj se ekspertët ishin shumë të qartë, edhe ndërhyrja e tyre ishte shumë e qartë.

Kalojmë në votim.

Kush është dakord me ndërhyrjen e bërë nga ekspertët? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Diskutime pa mikrofon.)

Pandeli Majko - Doni që ta votojmë edhe një herë?

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Kush është dakord me nenin, sipas ekspertëve? Kundër? Abstenim?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Miratohet, sepse vota ime është 2, e kam me vendim të Kuvendit.

Eduard Halimi – Komisioni i Venecias në këtë rast ka bërë një sugjerim dashamirës, tha njëri nga ekspertët. Për ne, votimi kundër këtij amendamenti kushtetues ka të bëjë me një çështje procedurale. E para, sepse komisioni nuk ka tagër të merret me çështjen e dekriminalizimit, por vetëm me çështjen e reformës në drejtësi.

E dyta, sepse për çështjen e dekriminalizimit, është i padiskutueshëm qëndrimi i Partisë Demokratike.

E treta, standardi që për çështjen e dekriminalizimit u përdor *double vote*, ka vetëm një qëllim, ta themi hapur, do ta them edhe jashtë: për të hequr mundësinë që personat me rekorde të tmerrshme kriminale të ndalohen përjetë. U tha edhe nga ekspertët, që kjo mund të jetë në kundërshtim me konventën, mund t'u drejtohen konventës. Ky është një qëndrim politik.

Unë kërkoj 10 minuta pushim për t'u konsultuar me kolegët për vijimin e procesit.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Lidhet me nenet që vijnë më pas, ka lidhje organike.

(Diskutime pa mikrofon.)

Zoti Majko, për procedurë.

Pandeli Majko – Të nderuar kolegë, në qoftë se quhet vendim absurd fakti që ne votojmë një opinion të Venecias, mendoj se duhet të rishikoni mënyrën e të shprehurit në këtë drejtim. Jeni në të drejtën tuaj, por proceduralisht e kërkoja fjalën për të nënvizuar këtë fakt.

Pjesa e dytë

Fatmir Xhafaj – Fillojmë!

Urdhëroni, zoti Halimi, për procedurë!

Eduard Halimi – Në emër të anëtarëve të opozitës në këtë komision, ju kërkoj ta tërhiqni vendimin që sapo morët, i cili është atentat i hapur ndaj ligjit të dekriminalizimit. Është atentat dhe mbrojtje ndaj personave, të cilët kanë një mandat deputeti apo duan të marrin një mandat deputeti dhe kanë rekorde të tmerrshme kriminale. Nëse ne po bëjmë një reformë këtu në drejtësi, e bëjmë që edhe ata persona, si Frroku apo persona të tjerë me rekorde të tmerrshme kriminale, të luftohen nga ky proces dhe jo të mbrohen. Vendimi u hap rrugë frokeve, që të vijnë në parlament, vendimi u hap rrugë atyre që të shkojnë në Gjykatë Kushtetuese dhe të anulojnë ligjin për dekriminalizimin. Kjo është një çështje fundamentale në këtë proces: ose do të bëjmë reformë në drejtësi që të luftojmë kriminelët, ose do të bëjmë

ligje që të mbrojmë kriminelët. Ndaj, propozimi im procedural është ky dhe dua një përgjigje nga ju zoti Xhafaj. Do ta tërhiqni, apo nuk do ta tërhiqni vendimin që sapo morët? Nëse nuk do ta tërhiqni, atëherë opozita e mbyll këtu mbledhjen e sotme.

Fatmir Mediu – Zoti Xhafaj, duke u pajtuar me shqetësimin e zotit Halimi, unë do t'ju kërkoja jo vetëm juve, por edhe ekspertëve ndërkombëtarë, meqenëse e kanë sjellë ata këtë propozim, ta tërheqin për ta parë në përputhje me atë proces të rëndësishëm për të cilën është shprehur edhe Bashkimi Europian, janë shprehur edhe SHBA-të, që është jashtëzakonisht jetik për zhvillimin normal të demokracisë në Shqipëri.

Kështu që, përpara qëndrimit tuaj, do të doja të kishte një qëndrim edhe të ekspertëve ndërkombëtarë në respekt të të cilëve jemi ulur dhe po diskutojmë për amendamentet që ata kanë bërë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Jam shumë dakord që të shprehen ekspertët ndërkombëtarë, edhe duke u dhënë atyre gjithë mirëkuptimin e nevojshëm, gjithë vlerësimin e merituar, por mendoj se kjo lloj gjuhe nuk është pozitive, sepse terma të tillë, si atentat, vrasje nuk e di se çfarë, nuk do të duhej të përdreshin në këtë tavolinë. Ne kemi marrë si detyrë të respektojmë besnikërisht atë çfarë është thënë në opinionin final të Komisionit të Venecias dhe ky është shtrati, korniza në të cilën është ndërtuar gjithë ky projekt. Ekspertët nuk kanë bërë asgjë tjetër vetëm një parashikim në ato që ju i keni listuar shpesh të Komisionit të Venecias, e kanë kthyer në një rregullim kushtetues dhe më duket se janë tepër korrektë me misionin e tyre dhe me atë në të cilën ne jemi dakordësuar.

Nëse çështja është e diskutueshme apo nuk është diskutueshme, kjo është një gjë që mbetet për t'u parë, por gjuha e përdorur është një gjuhë e rëndë, e cila nuk besoj se i shkon qëllimit të përbashkët dhe frymës që duam të krijojmë. Gjithsesi, meqenëse ju kërkuat të shprehet zoti Smibert, do ta ftoj të shprehet dhe të respektojë kërkesën tuaj.

Urdhëroni, zoti Smibert!

Jon Smibert – Shumë faleminderit! Në lidhje me nenin 6/1 dhe ndryshimin e bërë, siç e thashë edhe më parë, nuk ka qenë kërkesë e bërë nga ky Komision, nga Ekspertët e Nivelit të Lartë kur e kanë dërguar në Venecia. Ishte interpretim i një aspekti tërësisht të ndryshëm të Kushtetutës me legjislacionin zbatues që nuk ishte brenda paketës apo qëllimit të asaj që ne po diskutonim. Ne bëmë më të mirën tonë për atë interpretim bazuar në eksperiencën polake të përmendur. Sinqerisht, kjo është diçka që Komisioni mund ta lërë për një moment tjetër, ose të konsiderojë nëse nenet 17 dhe 6/1, së bashku janë në përputhje dhe jashtë qëllimit të këtij Komisioni. Mund t'i kërkojmë Komisionit të Venecias një përgjigje

për këtë pyetje të shkurtër. Kjo nuk është pjesë e paketës që Ekspertët e Nivelit të Lartë kanë marrë në konsideratë gjatë punës së 18 muajve të fundit. Nuk duhet ta shndërrojmë këtë në një pengesë për procesin e reformës në drejtësi, që po shkon mirë tani.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni, zonja Bernhard!

Agnes Bernhard – Faleminderit! Doja të shtoja vetëm një aspekt teknik. Komisioni i Venecias i referohet praktikës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut që kërkon që sanksionet të jenë në proporcion me veprimin e kryer. Ka praktikë gjyqësore nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut mbi ligjet e dekriminalizimit që kërkojnë parimin e proporcionalitetit. Komisioni i Venecias i referohet kësaj praktike me qëllim që të ketë fleksibilitet nga autoritetet shqiptare. Kështu që çfarëdo që vendosni, nëse sanksionet nuk janë proporcionale me veprimet e kryera atëherë mund të keni probleme me Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Fatmir Mediu - Në diskutime ne nuk dalim.

Eduard Halimi - Kjo është tryeza e reformës në drejtësi, nuk është tryeza për dekriminalizimin.

Fatmir Xhafaj - Me qetësi!

Eduard Halimi - Doni ta bëni reformën për të mbrojtur ata, në rregull bëjeni.

Fatmir Mediu - Zoti Smibert dha disa alternativa të mundshme. Meqenëse kjo ka ardhur nga ekspertët, duke vlerësuar raportin përfundimtar të “Venecias”, është mirë që kjo të tërhiqet derisa të vijnë në përputhje me atë që kemi miratuar të gjithë bashkë. Se çfarë ka diskutuar Gjykata e të Drejtave të Njeriut e të tjera, kjo është një çështje që del nga diskutimi. Kur kemi bërë ligjin për dekriminalizimin, i kemi analizuar që të gjitha edhe procedurat kushtetuese dhe procedurat jokushtetuese.

Të nderuar kolegë, do ju lutesha për të vazhduar punën normale të këtij komisioni, propozimin që bëri zoti Smibert, ta konsiderojmë jashtë diskutimit për momentin, derisa ai të vijë në përputhje të plotë me atë që është shqetësimi ynë i përbashkët, procesi i dekriminalizimit.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, e përsëris, e kemi parë me detaje raportin e Komisionit të Venecias për çështjen e dekriminalizimit; kemi parë çështjet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për këtë dhe e kemi bërë të bindur të dyja palët, ne edhe ju, në një komision të mandatar nga Kuvendi për dekriminalizimin, siç nuk është ky; e përsëris nuk është ky. Jemi jashtë kompetencave nëse e shqyrtojmë. Ka qenë debat politik i

pranuar më pas në nivel parlamentar që nuk është çështje për këtë komision në aspektin e procedurës. Në aspektin e substancës është e konsultuar me jurisprudencën europiane të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe me dokumentin e posaçëm të Komisionit të Venecias për çështjen e dekriminalizimit. Nëse do të ishte shkelje, do të ishte thënë, përbën shkelje, nuk do të thoshte është tendencë. Tani, nuk i shtoj asnjë gjë më shumë asaj që tha zoti Halimi për sa i përket qëndrimit tonë, por për të sqaruar këtë dyshim se paskemi shkelje të jurisprudencës së madhe të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në asnjë rast nuk ekziston kjo lloj shtate, çdo veprim shkon tek ajo që tha zoti Halimi në lidhje me qëndrimin politik të saj.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Majko!

Pandeli Majko – Për procedurë, mendoj se të dyja palët jemi të bindur për një gjë, me gjërat që nuk biem dakord ajo nuk do të miratohet në fund fare. Ne nuk mund të bëjmë dot votat e nevojshme për të ndryshuar Kushtetutën. Kështu që kompromisi do të jetë i rëndësishëm, i nevojshëm dhe në fund fare i domosdoshëm për të bërë votat për çdo nen, që do të kalojë këtu dhe në fund fare do të kalojë në parlament. Ideja se mund të kalojmë në mënyrë të njëanshme një nen, i cili juve më pas mund t’ju vërë në pozitë të vështirë në Kuvend, matematikisht nuk ekziston.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E shkruar e zeza mbi të bardhë, më pas i thënë edhe nga ekspertiza euro-amerikane, ishte: “Ky nuk është një propozim i ardhur nga ndonjë palë në këtë komision, por është një propozim, një vërejtje e Komisionit të Venecias dhe e zbardhur nga ekspertët ndërkombëtarë”. Nëse doni që ta ktheni këtë histori si një çështje politike ndërmjet nesh, nuk ekziston as si procedurë, as si fenomen. Mendoj se nuk duhet ta nxisni veten tuaj drejt gjesteve qesharake. Le të ecim të diskutojmë nen pas neni në vazhdim. Idetë se ne mund të kalojmë në mënyrë të njëanshme ndonjë nen që më pas do ta kalojmë në Kuvend, po e përsëris nuk funksion, nuk i kemi votat. Prandaj, ju lutem, kolegë, vazhdojmë me vullnetin që i keni shprehur në publik për të diskutuar nen pas neni problematikën. Edhe një herë, ju lutem nuk ka nevojë të bëjmë truke psikologjike apo politike në këtë histori. Askush nuk ju ofendoi për asnjë gjë politikisht, proceduralisht po të doni merreni dhe personalisht, sepse kjo punë kështu vajti.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Mendoj se mbajtja e linjës se çfarë është thënë nga Komisioni i Venecias është një kornizë mbi të cilën ne nuk duhet të cedojmë; është parimore, por, duke

qenë se kjo linjë mbështet në ekspertizën e ekspertëve ndërkombëtarë, ne i kemi thirrur për të na asistuar dhe për të na ndërmjetësuar teknikisht këtë proces. Mendoj se do t'i japim të drejtë zotit Smibert së bashku me zonjën Bernhard, që të kenë kohën e nevojshme për ta riparë përputhshmërinë e tij me të gjithë projektin edhe natyrisht me konsultim të mëtejshëm me Komisionin e Venecias. Le ta konsiderojmë këtë një nen që do të diskutohet përsëri në fund të projektit.

Eduard Halimi – Për procedurë.

Fatmir Xhafaj - E thashë, ua kemi lënë atyre që ta ridiskutojnë dhe ta rishikojnë me kërkesën e tyre. Ai kërkoi fjalën dhe unë po e respektoj.

Eduard Halimi – Ky nen u tërhoq nga ekspertët për t'u riparë dhe votimi i bërë në këtë është nul.

Fatmir Xhafaj - Votimi është fakt i kryer, por po them, është tërhequr prej tyre dhe nuk ka efekt. Po ju e votuat? Nuk votuat.

Eduard Halimi – Aktualisht, situata është kjo: neni është tërhequr nga ekspertët dhe votimi nuk ka efekt.

Fatmir Xhafaj - Është tërhequr nga ekspertët? Do të rishikohet përsëri në fund.

Eduard Halimi – Tani, ky nen është tërhequr nga ekspertët.

Fatmir Xhafaj – Do të rishikohet përsëri në fund.

Neni 4 . Ka ndonjë gjë për nenin 4?

Vasilika Hysi – Te neni 4 ka vetëm dy ndryshime redaktoriale. Te fjalia e parë lexohet: “Forcat e huaja ushtarake mund të vendosen ose të kalojnë në territorin shqiptar” dhe njëkohësisht në rreshtin e dytë të fjalisë duhet plotësuar me fjalët: “Forcat ushtarake shqiptare mund të dërgohen jashtë vendit”, pastaj pjesa tjetër është korrekte.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Urdhëroni!

Fatmir Mediu – Ka qenë shqetësim i vazhdueshëm i NATO-s fakti që ne kemi një procedurë shumë të ndërlikuar me miratimin në parlament të çdo rasti transiti të trupave në Shqipëri. Ne kësaj duhet t'i japim një zgjidhje përfundimtare, por nuk e ke dhënë përfundimtare, sepse prapë thua me ligj.

Fatmir Xhafaj – Po, sipas procedurës, do të bësh një procedurë dhe më pas mund t'ia kalosh Këshillit të Ministrave. Ligji do ta zgjidhë. Sot ti e ke me Kushtetutë.

Fatmir Mediu - Do t'ia japësh me ligj?

Fatmir Xhafaj – Po, po!

Vasilika Hysi – Ne me ligj e kemi lënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Atëherë, dakord.

Neni 5.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, lidhur me nenin 5 ka vetëm dy rregullime, që besoj se vijnë nga përkthimi, pra janë redaktoriale.

E para, do të themi: “Origjina shoqërore shqip” dhe kur thuhet: “Përkatësia shoqërore ose prindërore”, pra presja zëvendësohet me “ose”. Ndryshimi i fundit është ose mungojnë fjalët “për shkaqe të tjera”. Pra, shtohen fjalët “për shkaqe të tjera”, pastaj pjesa tjetër është e saktë.

Fatmir Xhafaj – Keni ndonjë koment?

Neni 6, “Ekstradimi”.

Eduard Halimi – Në fakt, neni 6 duhet rishkruar në pjesën, që ka të bëjë edhe nga ana e teknikës legjislativë. Pra, “Ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht marrëveshja ndërkombëtare ku republika është palë në vendim gjyqësor, si dhe kur parashikohet në legjislacionin e Bashkimit Europian”. Tani, këto duken si kushte kumulative, pra duhet të plotësohen të tria, në mënyrë që të ekstradohet. Në të vërtetë duhen “ose”, në mënyrë që njëri nga këta të ekzistojë, sepse kështu përjashtohet edhe ekstradimi me SHBA-në, që është marrëveshja e 30 e ca, si në kohën e Zogut. Kështu që ka një propozim lidhur me këtë nga ekspertët tanë që të jetë “ose”.

Fatmir Xhafaj – Bëtë një sugjerim, sugjerimin do ta shikojnë ata.

Eduard Halimi – Nuk duhet të jetë në mënyrë kumulative që të jenë të tria kushtet bashkë, por mjafton që njëri nga kushtet të ekzistojë.

Fatmir Mediu - Këtë e kam për ekspertët. Vetëm po e ngre si shqetësim. Ekstradimi që aplikojnë dënimin me vdekje për sa kohë Shqipëria nuk e ka dënimin me vdekje, duhet përjashtuar apo duhet lënë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni, zonja Bernhard!

Agnes Bernhard – Doja vetëm që të qartësoja diçka lidhur me çështjen që ngritët. Kjo i referohet urdhrit europian të arrestit, pra në skenarin kur ka një urdhër arresti nga një shtet i Bashkimit Europian atëherë ju do të prezumoni që standardet për ekstradimin janë në përputhje.

Fatmir Mediu – Në qoftë se është nga Teksasi që ka dënimin me vdekje?

Agnes Bernhard – Fjala që është shtuar i referohet vetëm urdhrit europian të arrestit.

Jon Smibert – Në anglisht, termi “po ashtu”, nuk duhet të ketë një kuptim akumulativ, duhet të jetë një marrëveshje ndërkombëtare “ose” standardet europiane. Duke parë shqipen, nëse ka një kuptim akumulativ, atëherë nuk duhet të jetë i tillë.

Fatmir Xhafaj – Neni 7.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

E mbështes ndryshimin e bërë, por kam një pyetje dhe një sugjerim për ekspertët. Neni 2 i protokollit 7 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut parashikon që e drejta e apelit në çështje penale, mund të përjashtohet për vepra të lehta penale, siç përcaktohet në ligj ose kur i interesuari ka qenë i gjykuar në shkallën e parë, nga gjykata më e lartë i shpallur fajtor dhe i dënuar në vijim të një vendimi kundër pafajësisë. Cila është arsyeja që vepra, ankimi, apelimi për çështje penale të lehta nuk parashikohet? A bie kjo ndesh me protokollin 7, që Shqipëria e ka ratifikuar?

Agnes Bernhard – Keni të drejtë, kjo mund të jetë e mundur, por është më e vështirë për ta eliminuar. Në rendin juridik shqiptar, gjithsesi ju keni një shkallë apelimi dhe kjo nuk duhet të ngrejë një problem në implementim.

Eduard Halimi – Në fakt, kjo dispozitë është riformuluar me të drejtë nga varianti i parë me idenë që të implementohet rekomandimi te paragrafi 16, i opinionit të ndërmjetëm, që kërkonte një saktësim të normës, si dhe në paragrafin 76, ku specifikohet se ligji rrezikon që të shkojë përtej kufijve të vendosur ndaj së drejtës për të apeluar në nenin 2 të protokollit 7, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut sipas kësaj dispozite. “Venecia” thotë: “kjo duhet të shmanget”, prandaj rekomandohet që të përafrohet kjo dispozitë me tekstin e neneve përkatëse të Konventës Europiane.

Në fakt, në vlerësimin tonë duhet rishikuar nga ana teknike edhe një herë, sepse së pari, Komisioni i Venecias ka rekomanduar përafrimin e tekstit me atë të Konventës. Në këtë rast Konventa nuk flet për kufizimin për çështjen civile apo administrative, por vetëm për çështjet penale. Duke lejuar vetëm kufizimin për veprat penale të lehta që parashikohen nga ligji ose kur i interesuari ka qenë gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë të deklaruar fajtor dhe të dënuar në vijim të një kundërshtimi kundër pafajësisë. Pra, teksti i rishikuar nuk e mban në konsideratë këtë dispozitë të KEDNJ-së.

Fatmir Xhafaj – E tha, zonja Vasilika dhe ratë dakord.

Eduard Halimi - Ajo që sugjerojmë ne për këtë, është që neni 43 i Kushtetutës të rrijë siç është dhe të bëhet vetëm një shtesë, kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm me ligj,

sipas kushteve të nenit 17 të Kushtetutës dhe ta rishikojnë ekspertët gjatë zbardhjes së vendimit.

Fatmir Xhafaj – Dakord me sugjerimin.

Urdhëroni!

Oerd Bylykbashi – Bazuar mbi standardet ndërkombëtare të përcaktuara edhe nga Komisioni i Venecias, edhe nga OSBE/ODHIR-i, Kodi Zgjedhor parashikon vetëm një instancë ankimi gjyqësor, në lidhje me çështjet zgjedhore. Standardet ndërkombëtare parashikojnë se edhe për hir të shpejtësisë të përmbylljes së procesit zgjedhor, sidomos kur jemi në kushtet edhe të një organi legjislativ pothuajse gjyqësor, siç është KQZ-ja, pra është i pranueshëm gjykimi vetëm me një instancë gjyqësore.

Fatmir Xhafaj – Po e ke bërë sot që e ke më të ngushtë, kurse kjo zgjeron. Kjo shkon në favor të asaj që thua ti.

Oerd Bylykbashi - Në momentin kur parashikohet ndryshimi në ligj, kjo që po them unë zgjidhet, kurse këto kufizimet e tjera, mund të rikthejnë diskutimin. Për ta pasur parasysh këtë gjë nëse do të na duhet ta riformulojmë.

Fatmir Xhafaj - E lamë që do ta rishikojmë, sepse edhe po e lamë fare me ligj, pastaj ligjvënësi mund ta tejkalojë, do një përkufizim në përputhje me konventën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Vetëm një fjalë. Në rregullimin që kemi pasur në nenin 43 e kemi lënë shumë të gjerë dhe evazive. Me këtë rregullim që kanë sjellë ekspertët kanalizohet, pra nuk mund të ketë arbitraritet, do të jetë gjithmonë për çështjet e efikasitetit të sistemit të drejtësisë dhe të interesave të personave, janë ato që ne i themi, krimet e lehta penale dhe gjithçka tjetër.

Fatmir Xhafaj – E lamë që ta bënin në përputhje me ...

Neni 8.

Gent Strazimiri – Çfarë u bë me nenin 7?

Fatmir Xhafaj – Po, pra, do ta riformulojmë me ndryshim, që ta përputhim me Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Vasilika Hysi – Te neni 8 kam një fjalë “çështje” që duhet zëvendësuar interesi më i lartë i fëmijës nuk zbatohet vetëm për çështje por edhe për politika, pra për të gjitha veprimet, aksionet e kufizon, sepse në variantin në anglisht nuk është çështje. Ne dhe kur hartojmë ligje, edhe kur bëjmë strategji, gjithmonë duhet të kemi interesin më të lartë të fëmijës jo vetëm në çështje. Ky është neni 3 i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut.

Gent Strazimiri – Si është në anglisht, që ta shqipërojmë?

Jon Smibert – Në të gjitha veprimet lidhur me fëmijët, prioritet duhet të jetë interesi më i lartë i fëmijës.

Fatmir Xhafaj – Në rregull hiqet fjala “çështjet” dhe kalojmë “në aspektet”. Megjithatë kanë të drejtën që të rishikohen me kujdes dhe të mos bëjmë shpikje këtu.

Neni 9. Dakord.

Neni 10. Besoj se biem dakord.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, i vetmi redaktim është që në fjalinë e dytë të heqim “në këto raste”, sepse paragrafi i 3 flet, pikërisht për deputetët që mund të ndalohen dhe të arrestohen. Të fillojmë direkt drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ose prokurori i Përgjithshëm njofton menjëherë Kuvendin. Kam një pyetje për ekspertin kur themi pas kryerjes së një krimi të rëndë.

Fatmir Xhafaj - Kjo është në Kushtetutë sot. Është thjesht kompetencë procedurale.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, pavarësisht se çfarë shikojmë ne sot, ka një hierarki edhe logjike. Fjalja të ishte: “Prokurori i Përgjithshëm ose drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme”... Në rregull, por tregon diçka që nuk shkon, sepse ka një hierarki të zgjedhur nga 3/5 dhe është Prokuror i Përgjithshëm.

Si rregull, procedura mund të jetë e tillë që ai i kërkon prokurorit, po se bëri ky e bën vetë.

Fatmir Xhafaj – Dakord!

Neni 11.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – “Në këto raste” të hiqet, sepse në Kushtetutë nuk thuhet, në këto raste, është në të folurën e përditshme. Thuhet: “Deputeti mund të ndalohet ose arrestohet pa autorizim kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë.” “Prokurori i Përgjithshëm ose drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton menjëherë Kuvendin, i cili kur konstaton se nuk ka vend për procedim, vendos për heqjen e masës”.

Fatmir Xhafaj – Shtojmë fjalët: “Prokurorinë e Posaçme”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Dakord do të bëjmë vetëm zëvendësimin siç u tha “Prokuror i Përgjithshëm”.

Neni 11.

Vasilika Hysi - Kam një pyetje për ekspertët për fjalët: “Për veprimet e Këshillit të Ministrave”. Sugjeroj se Kuvendi mund të nxjerr rezoluta jo vetëm për veprimet, por edhe për qëndrimet e Këshillit të Ministrave në institucionet e BE-së, pasi në parlament nuk ka

vetëm votë, por ka deklarata, qëndrime, opinione që shprehen. Fjala “veprim” nuk shpreh edhe qëndrimin.

Fatmir Xhafaj – Mirë po i ka përmbledhur të gjitha me qëndrimin, me aktet e të tjera. Veprimi i ka gjitha, është më i gjerë, sepse edhe qëndrimi është i përfshirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë do t’ia kalojmë edhe atij që merret me pjesën gjuhësore.

Dakord.

Neni 12.

Oerd Bylykbashi – E drejta për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur u njihet edhe shteteve të Bashkimit Europian, të cilët jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas legjislacionit të BE-së dhe rregullave përcaktuara nga Kodi zgjedhor. Ai e merr të drejtën sipas Kodit Zgjedhor, nuk aplikohet legjislacioni. Çfarë do të thotë, sipas legjislacionit? E gjithë kjo do të transpozohet në Kodin Zgjedhor.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord me anëtarësimin, sepse e pranuar atë logjikë. Edhe një herë, sipas legjislacionit të BE-së dhe rregullave të Kodit Zgjedhor, Kodi Zgjedhor do të konformohet me legjislacionin Europian, duket sikur aplikohen dy legjislacione në të njëjtën kohë.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Agnes Bernhard – Në Bashkimin Europian, qytetarët e vendeve të tjera anëtare kanë të drejta zgjedhore të caktuara dhe kjo e bën drejtpërdrejt të aplikueshme atë që Gjykata Europiane e Drejtësisë ka shprehur lidhur me legjislacionin e BE-së. Kjo ka të bëjë me situatën kur një shtet është anëtarësuar dhe keni burime ligjore dyfishe të cilat mund të jenë në konflikt.

Oerd Bylykbashi – Në sistemin me të cilin do të zgjidhet dhe do të votojë dhe për rrjedhojë do të delegojë nëpërmjet votës së tij anëtarë në Parlamentin Europian, nuk shikoj ndonjë problem që Kodi Zgjedhor të konfirmohet dhe të ketë kapituj të veçantë vetëm për këtë gjë, por nuk ka për të qenë detyrim i Shqipërisë për ta bërë këtë. Kjo na krijon konfuzion në zbatimin e dy të drejtave për qytetarët që i kanë, sepse është e gjithë dispozita, por i njeh të drejtën qytetarit të BE-së që jeton në Republikën e Shqipërisë të votojë sipas legjislacionit të Bashkimit Europian.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull, por për cilat zgjedhje? Zgjedhjet shqiptare, zgjedhjet e Parlamentit Europian apo zgjedhjet lokale?

Të them të drejtën do konfirmohet legjislacioni shqiptar, nuk mund të përplasim dy norma, sepse normat kanë dy sisteme të ndryshme votimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtu thotë: “sipas legjislacionit të Bashkimit Europian dhe rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Në rregull.

Neni 13. Dakord.

(Diskutime pa mikrofon.)

Jemi te 13 nenet e para. Sot e mbyllim dhe nesër vazhdojmë me pjesën e dytë, siç e kemi lënë me Gjykatën Kushtetuese duke filluar nga neni 14 deri 24. 10 nene për nesër.

Nesër takohemi këtu në orën 11:00!

Faleminderit!

MBLEDHJA MBYLLET

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë